PRANUAR ME: / ACCEPTED ON: / PRIMLJENO: 02/05/2025
02/143

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

---

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së -I- (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja u mbajt me datë: 28.02.2025 dhe filloi në ora: 10:20.

**Në mbledhje morë pjesë:** Kryesuesi i Kuvendit Argjend Thaçi, Drejtori për Ekonomi, Financa dhe Buxhet Blerim Thaçi, antarët e komisionit: Rukije Bytyqi, Veton Zogaj, Gentianë Hoti, Hamit Lima, Sadik Vranezi, Këshilltar ligjor i Kuvendit Muharrem Morina, përfaqësuesi nga OSBE dhe zyra për informim.

**Mungon:** Arlindë Rudi (PDK).

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit)**: Përshëndetje për të gjithë dhe mirë se keni ardhur!
Hapi mbledhjen e -I- (parë) të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa. Prezent në mbledhje jemi 6 anëtarë dhe mund të vazhdojmë me punimet e mbledhjes. Kush është për këtë rend të ditës?
Me vota unanime të gjashtë anëtarëve, Kryesuesi konstatoi se u miratua ky:

Rend i ditës:

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të rregullt e mbajtur me datë: 23.08.2024 dhe procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të rregullt mbajtur me datë 16.12.2024.
2.Shqyrtimi i Raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2024.
3.Shqyrtimi i Planit vjetor të Prokurimit publik.
4.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024
5.Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024.
6.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
7.Shqyrtimi i miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025.
8.Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2025.
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme.

Pika e parë
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të rregullt e mbajtur me datë: 23.08.2024 dhe procesverbalit të mbledhjes së gjashtë të rregullt mbajtur me datë 16.12.2024.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Kush është për miratimin e procesverbalit?
Me vota unanime të 6 anëtarëve, kalon kjo pikë.

Pika e dytë
2.Shqyrtimi i Raportit të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën janar-dhjetor 2024
**Argjend Thaçi ( Kryesues i Kuvendit):** Urdhëro, drejtor!

**Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa):** Sipas të dhënave të prezantuara në tabelat përkatëse del së KK Malishevë ka një buxhet të miratuar nga Kuvendi Komunal për vitin fiskal 2024, shumën prej 19,740,806.00E për të gjitha programet dhe nënprogramet, mirëpo duke përfshirë të hyrat vetanake nga të gjithë sektorët, si total kap shumën 22,029,503.07E. Sipas shënimeve nga librat e thesarit del se shkalla e shpenzimit të buxhetit të realizuar për periudhën janar-dhjetor 2024 është 21,639,360E. Sipas buxhetit për vitin fiskal 2024, nga të hyrat vetanake janë planifikuar të mblidhen 916,849.00E dhe tejkalimi 1,141,860.02 E, që shuma totale e THV për periudhën janar dhjetor 2024 është 2,058,709.02E, që do të thotë kemi një tejkalim të planifikimit për 225%. Nëse e shtojmë TM4, realizimi i të hyrave vetanake kap 244%.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Urdhëro, Veton!

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Unë vazhdimisht e kam lavdëruar punën e drejtorit, sidomos për të hyrat vetanake dhe në këtë raport po e shohë që po vazhdon ky trend i të hyrave vetanake. Tek gjobat në trafik në vitin 2023 kanë qenë 69,967.33E dhe tani është dukshëm më e rritur, në vitin 2024 janë 248,803.00E. Taksa për certifikata të pronësisë është një ulje për 3.000.00E. Participimi i qytetarëve ne bujqësi në vitin 2023 janë 24,788.52E, ndërsa në vitin 2024 janë 2,337.00E. Nuk e di pse këto dy kategori janë me vlera më të ulëta.
Tek shpenzimet i kemi disa kategori që në raportin e vitit 2023 në periudhën e njëjtë kanë qenë zero ndërsa në këtë vit ka ngritje.
Shërbime konsulentë në vitin 2023 kanë qenë zero, ndërsa në vitin 2024 janë 65,284.34E. Është një shumë e lartë dhe nëse ke mundësi në kuvend me na bashkangjitur një shtojcë raportit se për qfarë shërbime janë kryer, në qfarë projekte janë përfshirë këta ekspert të këtyre fushave.
Tek shërbimet teknike e ke një dyfishim, në vitin 2023 kanë qenë 23,874.60E, ndërsa në vitin 2024 janë 40,864.76.
Mobilje 1000E, në vitin 2023 kanë qenë 27,410.23E, ndërsa në vitin 2024 janë 38,946.50E.
Blerje e librave dhe veprave artistike në vitin 2023 kanë qenë zero, ndërsa në vitin 2024 janë 54,020.00E. Cilat shkolla janë furnizuar me këto libra?
Karburant për vetura , gjenerator është rreth 15,000E rritje.
Mirëmbajtja e ndërtesave në vitin 2023 kanë qenë 3,397.32 ndërsa në vitin 2024 janë 127,647.43.
Mirëmbajtja e rrugëve lokale në vitin 2023 janë 29,999.70 ndërsa në vitin 2024 janë 73,399.45.
Vendimet e gjyqësorit është shifër shumë e lartë.

**Argjend Thaçi (Kryesues i Kuvendit):** Urdhëro, Blerim!

**Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa):** Është një kontratë dy vjeçare për furnizimin e librave dhe dhuratave dhe në kuadër të kësaj hynë dhe furnizimi nëpër shkolla me ditar dmth me material pedagogjik për shkolla. Kjo është e kontraktuar nga Ministira.
Te participimi i qytetarëve në bujqësi në këtë vit participimi me subvensione dallon në bazë të marrëveshjes që e kemi bërë.
Te certifikatat në pronësi është qështje e certifikatave në pronës, është qështje e personave se sa kanë aplikuar.
Te vendimet gjyqësore- kur ekzekutohen pagesat nuk na pyet se ku me i marr por i marrin nëpër të gjitha këto kategori që janë të paraqitura.

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Tek vendimet gjyqësore 201,988.44E, i prek dhe këto kategoritë tjera.

**Blerim Thaçi (Drejtor për buxhet dhe financa):** Po i prek të gjitha kategoritë. Ne kemi konsulent aktiv, mirëpo nuk do të thotë që 65,000.00E i kemi paguar ne ata, mirëpo po merren mjetet nga të gjitha kategoritë.
Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve është strikt mirëpo është rrit kostoja dhe në bazë të shpenzimit të lëndëve përmbarimore. Ka mundësi të jenë dhe pagesa dhe të vitit 2023.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Urdhëro, Hamit!

**Hamit Lima (anëtar nga LDK):** Avans për udhëtimet zyrtare çka nënkupton?
Mirëmbajtja e rrugëve në vitin 2023 janë 30,000.00E, ndërsa në vitin 2024 janë 73,399.45E.
Është një diferencë shumë e madhe mirëpo rrugët i kemi shumë keq.
Tek mirëmbajtja e shkollave në vitin 2023 i kemi pasur 16,221.69, ndërsa në vitin 2024 i kemi 81,437.30E.
Tek mobilje janë 29,946.50E,çfarë shpenzime janë kryer.

**Argjend Thaçi( Kryesues i Kuvendit):** Urdhëro, drejtor!

**Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa):** Pjesa e avanseve janë udhëtimet zyrtare jashtë vendit.
Tek qështja e kontratës së mirëmbajtjes së shkollave është një kontratë që ka përfunduar në vitin 2023, ndërsa kontrata e re është për këto renovimet që po bëhen. Është mirëmbajt shkolla e mesme teknike në Kijevë, në shkollën në "Ibrahim Mazreku" dhe në disa shkolla të tjera.
Në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve është dhe pastrimi i borës, pastrimi rreth rrugëve. Ka ende punë sepse nuk është paguar as 50% e kontratës.
Kontratat për mobilje i bënë niveli qendror, kërkesat janë nga shkolla, nga administrata për furnizim dhe ne i paguajmë. Në administrat janë pajisur dy zyre me mobilje, ka mundësi nëpër shkolla dhe në çerdhe.
Në javën e parë të shkurtit e kemi pasur një ekzekutim të lëndëve përmbarimore të shujtave të mësimdhënësve, shuma ka qenë 834.000.00E dhe neve na ka dëmtuar shumë në këto kategori.
Pjesa më e madhe e shpenzimit na ka ndodhur te kapitalet dhe tek mallrat dhe shërbimet.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Urdhëro, Hamit!

**Hamit Lima (anëtar nga LDK):** Këto mjetet e shujtave, në vitin e ardhshëm ju kthejnë nga niveli qendror.

**Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa):** Deri vitin e kaluar pjesën më të madhe të mjeteve i kanë marr në kategorinë e pagave, në vitin e kaluar kur kemi ardhur në fund ne kemi pasur minus pagat vetëm për muajin dhjetor, ndërsa në këtë vit pagat janë të mbyllura, na kanë detyruar me i zotu për 12 muaj.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Ne si Kuvend jemi keq me disa pagesa të vendimeve të Kuvendit që nuk po ekzekutohen. Kërkoj që ju si drejtori të merreni si drejtori më intenzivisht këtë vit me këto pagesa të këtyre kërkesave.

**Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa):** Unë besoj që do realizohen pagesat e këtyre kërkesave. Dhe një kërkesë e kam për bartjen e mjeteve me sjellë direkt ne Kuvend.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Shumë komuna janë duke i bërë pagesat e Komiteteve dhe Komisioneve, pse komuna jonë jo. Sa i përket bartjeve të mjeteve kjo duhet të kaloj përmes KPF-së

**Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa):** Ajo pagesë si ata i bëjnë është e jashtëligjshme.

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** Nëse ne marrim vendim psh. 20.000.00E për këto Komisione ai është i plotë fuqishëm dhe Ministria nuk e kthen të paligjshëm sepse është vendim i Kuvendit. Sa i përket bartjes së mjeteve mundemi gjysmë ore para fillimit te mbledhjes së kuvendit, me thirr mbledhje të jashtëzakonshme të KPF-së dhe pastaj e dërgojmë në Kuvend.
Sa i përket Komiteteve kostoja është më e madhe nëse dikush nga Komitetet i dërgon me përmbarues.

**Blerim Thaçi ( Drejtor për Buxhet dhe Financa):** Ligji i financave nuk e njeh.

**Veton Zogaj (anëtar nga VV):** E njeh vendimin e Kuvendit.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Përmes mallrave dhe shërbimeve dhe formave të tjera janë duke u bërë pagesa, i'a bashkangjet vendimin e asamblesë komunal. Urdhëro, Hamit!

**Hamit Lima (anëtar nga LDK):** Sa i përket Komiteteve, drejtor është më mirë me i paguar deri këtu dhe me kërkuar nga asamble që të gjitha këto Komitete apo Komisione që janë formuar nga Kuvendi me i shfuqizuar. Më mirë është që të shfuqizohen se sa të vazhdohet kështu. Ne si Komision i Ekoregjionit e kemi një vendim që e kemi pagë mujore 200E dhe mundem atë vendim ta dërgojm në përmbarues.

**Blerim Thaçi (drejtor për Buxhet dhe Financa):** Telashja më e madhe ka qenë te Komisioni për përzgjedhjen e këshillave nëpër fshatra 100E një mbledhje.

**Gentianë Hoti (anëtare e Nisma Socialdemokrate):** Kur është marrur vendimi është dashur me u konsultuar dhe me ju thënë mos e bënë mëditjen 100E, por më pak sepse nuk kam mundësi t'i paguaj

Blerim Thaçi (Drejtor për Buxhet dhe Financa): KKSB-ja është një organ i formuar nga Kuvendi dhe çdo komunë e ka aktiv, ndoshta ndonjë komunë që e ceku kryesuesi është duke i paguar mirëpo ne nuk po mundemi me gjet formën si të bëjmë pagesën. Nëse e gjejmë formën unë jam për ti bërë pagesat.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Kalojmë në pikën e tretë shqyrtimi i Planit vjetor të Prokurimit publik. Prezent nuk e kemi askënd nga prokurimi, mirëpo po e dërgojmë në kuvend dhe e diskutojmë në mbledhje. Kush është që Plani i prokurimit të rekomandohet për Kuvend?
Me 5 vota për, një abstenim kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Kalojmë në pikën e katërt shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024. Kush është për rekomandim për kuvend këtë pikë?
Me vota unanime këtë pikë e rekomandojmë për kuvend.

Kalojmë në pikën e pestë shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2024.Kush është për që kjo pikë të rekomandohet për Kuvend?
Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për kuvend.

Pika e gjashtë e rendit të ditës është shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024. Kush është që kjo pikë të rekomandohet për kuvend?
Me vota unanime kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Pika e shtatë e rendit të ditës është shqyrtimi i miratimi i Planit të punës së Kuvendit për vitin 2025.

**Izet Shala**: A po i vendosim në Plan të kuvendit strategjin dhe planin e veprimit.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Kush është për rekomandim për kuvend me plotësim ndryshim që dhe këto pikë të hynë?
Me vota unanime, kjo pikë rekomandohet për Kuvend.

Pika e 8 është shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Komitetit për arsim, kulturë, rini dhe sport për vitin 2025.
Kush është për rekomandim për kuvend?
Me vota unanime të 6 anëtarëve kjo pikë rekomandohet për kuvend.
Kalojmë te pika shqyrtimi i kërkesave.
Kërkesa nga Gania dhe nga Fatimja i kemi lënë në mbledhjen e kaluar për shqyrtim në këtë mbledhje po i rekomandojmë për kuvend. Janë kërkesa me kancer. E kemi dhe kërkesën nga Zejnepe. kërkesën nga djali i Hajdin Berishës i cili është në gjendje të rëndë shëndetësore. Kërkesën 02/303, 02/32, 02/165, 02/417, 02/01 këto të rekomandohen për Kuvend. Me vota unanime këto kërkesa rekomandohen për kuvend.

Kërkesa tjetër është nga Gëzim Bytyqi.

**Gentianë Hoti (anëtare nga Nisma Socialdemokrate):** Është me stenda dhe nuk mund të punojë, kushtet i ka shumë të dobëta.

**Argjend Thaçi (Kryesuesi i Kuvendit):** Kërkesa nga Zyrafete Paqarizi, Mihide Ibrahimi, Gëzim Bytyqi dhe Nura Krasniqi po ju ndajmë nga 500E për secilën. Kush është për që këtyre kërkesave të ju ndahen nga 500E?
Me vota unanime, miratohen këto kërkesa.
Kërkesës nga Fatmire Berisha dhe kërkesës nga Ilir Guncati po ja ndajmë nga 400E. Kush është për që këtyre dy kërkesave të ju ndajmë nga 400E?
Me vota unanime këto kërkesa miratohen.
Kërkesa për zjarr nr.01/479 po ja ndajmë 500E. Kush është për?
Me vota unanime kësaj kërkese i ndahen 500E.

Këtë mbledhje e shpalli të mbyllur. Ju falënderojë për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora: 11:40.

Procesmbajtësja: Kryesuesi i Kuvendit

Albina Zulfaj-Morina Argjend Thaçi